



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 522/9Prot.

Tiranë, më 22.06.2018

V E N D I M

Nr. 55, Datë 22.06.2018

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË 2 SUBJEKTE
“PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E
MËPARSHME TË EVADUARA PËR PERIU DHËNË E 6-MUJORIT TË DYTË TË
VITIT 2017”**

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH gjatë auditimeve të evaduara gjatë 6 - mujorit të dytë të vitit 2017, sipas programit të auditimit nr. 522 datë 26.04.2018 si dhe në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Kryetarit nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat për ndekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit” rezultoi se në 2 subjekte të audituara janë rekomanduar dhe pranuar nga ana e subjekteve gjithsej 56 masa. Analiza sipas llojit të rekomandimit paraqitet:

1. Masa organizative

Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 10 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 10, janë zbatuar 4 masa dhe janë në proces zbatimi 6 masa.

2. Masa shpërblim dëmi.

Për shpërblim dëmi janë lënë 6 rekomandime për shumën 802,617 mijë lekë, nga të cilat, janë pranuar 6 rekomandime. Nga rekomandimet e lëna janë zbatuar plotësisht vlera prej 311,825 mijë lekë, janë në proces zbatimi vlera prej 35,038 mijë lekë dhe janë pa zbatuar vlera prej 455,753 mijë lekë

3. Masa disiplinore.

Mbështetur në nenin 58 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” janë rekomanduar:40 masa disiplinore nga të cilat janë pranuar 40 masa, dhe gjendja e këtyre rekomandimeve paraqitet 18 të zbatuara, dhe 22 masa të pa zbatuar.

Bazuar në rezultatet e mësipërme mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt Vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti

i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evadua në periudhën e 6-mujorit të dytë të vitit 2017”, sipas programit të auditimit nr. 522 datë 26.04.2018 të ushtruar në 2 subjekte të audituara.

II. Të rikërkoj marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve për subjektet si më poshtë:

I. DREJTORIA RAJONALE TATIMORE SHKODËR

Kontrolli i Lartë i Shtetit ushtroi auditim në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me zbatimin e rekomandimeve të dërguara me shkresën e KLSH-së nr. 472/7, datë 27.09.2017, sipas drejtimeve të programit të auditimit nr. 472/1, datë 21.06.2017.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtorja Rajonale Tatimore Shkodër ka hartuar një plan pune me nr. 9606/1/ datë 02.10.2017 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së me të cilin janë ngarkuar për zbatim Drejtorja e Kontrollit Tatimor, Drejtorja e Mbledhjes me Forcë dhe Drejtorja e Analizës dhe IT, por nuk ka njoftuar KLSH me shkresë për punën e bërë sipas afatit ligjor prej 20 ditëve nga marrja e njoftimit.

Në zbatim të pikës 2, nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtorja Rajonale Tatimore Shkodër, edhe pse i ka marrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve të lëna, nuk ka dërguar informacion për punën e bërë brenda afatit 6 muaj lidhur me zbatimin e rekomandimeve

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 4 rekomandime gjithsej, nga të cilat 3 masa organizative, 1 masë shpërblim dëmi me vlerën 2,742 mijë lekë,

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 3 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 3 masa, nga të pranuarat, konsiderohen të zbatuara plotësisht 2 masa dhe është në proces zbatimi 1 masë.

b. Për shpërblim dëmi është lënë 1 rekomandim në shumën 2,743 mijë lekë, i cili është pranuar, janë nxjerrë njoftimet e vlerësimit për të 6 subjektet e rekomanduara dhe deri në verifikimin e zbatimit të rekomandimit rezultoi se nga 5 subjekte janë arkëtuar 2,667,518 lekë dhe mbetet pa u arkëtuar detyrimi i subjektit [REDAKTUAR] për shumën 75,660 lekë subjekt i cili ka kaluar pasiv.

c. I është rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve që në vlerësim të gjetjeve të evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të gjykojë për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore sipas nenit 59 pika 2 e ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të cilat janë në nivelin e masës nga “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj, sipas nenit 58, germa “b” deri në “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” sipas nenit 58 germa “c”.

Nga auditimi është konstatuar se DRT Shkodër nuk ka respektuar afatet ligjore prej 20 ditësh dhe 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm e cila ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Institucionit.

Për rekomandimin që konsiderohet në proces zbatimi, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Zbatimit të Rekomandimeve, i kërkojmë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër të përshpejtojë realizimin e plotë brenda 9-mujorit të vitit 2018.

II. DEGA E DOGANËS TIRANË

Kontrolli i Lartë i Shtetit ushtroi auditim në Degën Doganore Tiranë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me zbatimin e rekomandimeve të dërguara me shkresën e KLSH-së nr. 640/15, datë 06.10.2017, depozituar në Degën e Doganës Tiranë me nr. 10488, datë 11.10.2017.

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, DD Tiranë, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijani, me shkresën nr. 10488, datë, 30.10.2017, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 640/18, datë 02.11.2017, së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuara.

- Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Dega Doganore Tiranë me shkresën nr. 3481, datë 10.04.2018 “Dërgim të relacionit të grupit të punës mbi Raportin Përfundimtar të Auditimit ardhur sipas shkresës nr. 640/15, datë 06.10.2017” drejtuar KLSH, (nr. 640/32, datë 19.04.2018 tonën), informon në mënyrë të detajuar lidhur me zbatimin e rekomandimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **7 masa organizative**, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 7 masa, nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 2 masa, dhe janë në proces zbatimi 5 masa.

b. Për **masa shpërblim dëmi** janë lënë **5 rekomandime** në shumën **799,874 mijë lekë**, ku janë analizuar rekomandimet sipas pikave përkatëse, sipas shumave dhe subjekteve për shpërblim dëmi për të proceduar me aktet përkatëse nga organi vendimmarrës. Janë pranuar 5 masa nga të cilat 1, masë është zbatuar plotësisht, 3 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 1 masë nuk është zbatuar. Në vlerë, janë zbatuar plotësisht vlera prej 309,083 mijë lekë, janë në proces zbatimi vlera prej 35,038 mijë lekë dhe janë pa zbatuar vlera prej 455,753 mijë lekë.

c. Është rekomanduar **1 masë për shqyrtimin e përgjegjësive të personave të atakuar në Raport**, e cila është pranuar, duke dhënë 18 masa disiplinore “vërejtje”. por nuk është zbatuar.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve u konstatua se nuk janë zbatuar, një pjesë e rekomandimeve për të cilën **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE TË PAZBATUARA

2.1 Rekomandimi. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të shfuqizojë shkresat **nr. 1945 prot, datë 25.01.2016** dhe **nr. 2344 prot, datë 28.01.2016** të DPD, lidhur me vlerësimin doganor të mallrave të kapitullit *02* të Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave, të cilat bien ndesh me kërkesat e Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë së Financave

“Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore... dosjes së të dhënave të disponueshme për shpenzimet e transportit...”.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI TË PAZBATUARA

Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave i rekomandojmë marrjen e masave për realizimin e masave shpërblim dëmi të pazbatuara si më poshtë:

1.1 Rekomandimi. Dega e Doganës Tiranë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën **333,707 mijë lekë** nga subjektet, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 14-23 dhe sipas tabelës nr. 1, të Raportit Përfundimtar të Auditimit të Zbatimit të Rekomandimeve.

Në vijimësi

2.1 Rekomandimi. Dega e Doganës Tiranë të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **239 raste/subjekte**, në vlerën **124,418 mijë lekë** nga subjektet, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 23 - 25 dhe sipas tabelës nr. 2, të Raportit Përfundimtar të Auditimit të Zbatimit të Rekomandimeve.

Në vijimësi

4.1 Rekomandimi. Dega Doganore Tiranë të ndjekë arkëtimin e detyrimeve doganore dhe gjobave doganore në **shumën 37,056 mijë lekë** për shkelje doganore të kryera nga operatorë të tregtar për veprime të kryera në kundërshtim dhe tejkalim të afateve administrative gjatë veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike RPA, RLP dhe hedhjes në qarkullim të lirë mallrave të importuara më parë nën regjimin RPA dhe RLP duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, me qëllim arkëtimin e detyrimeve dhe sanksioneve doganore, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 25 - 30 dhe sipas tabelës nr. 3, të Raportit Përfundimtar të Auditimit të Zbatimit të Rekomandimeve.

Në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

Nisur nga vlerat e larta të dhëna në rekomandimet për “MASA PËR SHPËRBLIM DËMI” niveli i masave disiplinore “vërejtje”, nuk është në proporcion të drejtë me gjetjet dhe vlerat e rekomanduara, të cilat u formalizuan në vendime administrative. Nga ana tjetër në rekomandim kemi përcaktuar gërmën nga “b derri ne ç” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013.

1.1 Rekomandimi. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në vlerësim të shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të përcjellë më shkresën nr. 640/15, datë 06.10.2017 të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të lartë të Shtetit, pasi të bëjë klasifikimin e tyre, sipas pikës 1, germa “b”, “c” dhe “ç” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, trajtuar më hollësisht dhe në faqet nr. 31 – 32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit të Zbatimit të Rekomandimeve.

Menjëherë

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi apo të zbatuara pjesërisht të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Zbatimit të Rekomandimeve, të inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 9-mujorit të vitit 2018.

Pavarësisht auditimit që ne kemi kryer për zbatimin e rekomandimeve, ju kujtojmë që në mbështetje të nenit 15 germa “j” të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, jeni të detyruar që brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve tona, duhet të raportoni me shkrim pranë KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve tona.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit. Ky vendim përcillet në formë rekomandimi në subjektin e auditimit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R